



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe vendimit me numër KGJK.Nr.185/2021, të datës 28 korrik 2021 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 18 tetor 2021,

Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2021**

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV  
04/2019 PËR PUBLIKIMIN E AKTGJYKIMEVE TË PËRPUNUARA**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi është plotësimi dhe ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr.04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

## **Neni 2**

1. Në tërë tekstin e udhëzimit administrativ bazë, pas fjalës “**aktgjykim**” përshtatshëmrisht shtohet fjala “**dhe aktvendim, përkatësisht aktvendim meritore**”, si në njëjës ashtu edhe në shumës.

## **Neni 3**

Në nenin 1 të udhëzimit bazë, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri si në vijim:

1. Me këtë udhëzim përcaktohet edhe mënyra e publikimit të aktvendimeve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, si dhe publikimin e aktvendimeve meritore të gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

## **Neni 4**

Pas nenit 2 të udhëzimit bazë, shtohet një nen i ri si në vijim:

### **Neni 2A**

#### **Kufizimi i publikimit të aktvendimeve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit**

Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit duhet të publikojnë të gjitha aktvendimet, përveç kufizimeve të publikimit të përcaktuara me nenin 2 të udhëzimit bazë, duke përfshirë edhe aktvendimet e rasteve të dhunës në familje, masave siguruese në çështjet familjare si dhe rastet e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 5**

Pas nenit 2A të shtohet një nen i ri si në vijim:

### **Neni 2B**

#### **Kufizimi i publikimit të aktvendimeve meritore të gjykatave themelore**

1. Gjykatat themelore duhet të publikojnë të gjitha aktvendimet meritore, përveç:
  - 1.1. aktvendimi për adoptim;
  - 1.2. aktvendimi për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar;
  - 1.3. aktvendimi për vendosjen dhe mbajtjen e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor;
  - 1.4. aktvendimi me të cilin caktohet dhe ndryshohet masa e trajtimit psikiatrik në liri apo në institucionet e kujdesit shëndetësor në ndalim;
  - 1.5. aktvendimi për vazhdimin dhe pushimin e së drejtës prindërore;

- 1.6. aktvendimi për dhënien e lejes për lidhjen e martesës;
- 1.7. aktvendimi i rasteve të dhunës në familje;
- 1.8. aktvendimi për masa sigurorese në çështjet familjare; si dhe,
- 1.9. Rastet (rastet e seancave të mbyllura dhe rastet e tjera) të parapara me legjislacionin në fuqi.

## Neni 6

Neni 3 paragrafi 1 i udhëzimit bazë, riformulohet si në vijim:

1.1. **Aktgjykim**- nënkupton të gjitha aktgjykimet e gjykatave të Republikës së Kosovës;

Neni 3 paragrafi 1 i udhëzimit bazë, pas nënparagrafit 1.1. shtohen dy nënparagrafe të reja si në vijim:

1.2. **Aktvendim** - nënkupton të gjitha aktvendimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës;

1.3. **Aktvendim meritor**- nënkupton të gjitha aktvendimet meritorë të gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

2. Pas përfshirjes së dy nënparagrafëve të ri, ndryshohet renditja e nënparagrafëve në udhëzimin bazë, ashtu që rristohet radhitja numerike e nënparagrafëve të tjera në këtë nen.

## Neni 7

Ky udhëzimi administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë : 22.10.2021